



Empowered lives.
Resilient nations.

SHPALLJE PËR TRAJNIME NË PËRGATITJEN E PRODUKTEVE USHQIMORE

Organizata joqeveritare "Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës" (IADK) është duke zbatuar projektin "**Përkrahja e grave dhe vajzave në fuqizimin ekonomik përmes vetëpunësimit dhe ngritjeve të kapaciteteve profesionale të tyre**" në komunën e Vitisë si pjesë e Programit Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Qëllim i projektit është të kontribuoj në fuqizimin ekonomik të grave duke krijuar mundësi punësimi dhe përmirësimin e mirëqenies së tyre dhe të familjeve të tyre përmes ngritjes së kapaciteteve profesionale në përpunim të ushqimit.

Paraprakisht, IADK do të organizoj një kurs trajnimi me katër (4) grupe, të cilat do të aftësohen profesionalisht në përgatitjen e ushqimeve tradicionale (2) grupe, , pemëve dhe perimeve (1) grup dhe qumështit (1) grupe.

Konkursi për aplikim për secilin modul është si në vijim:

- Përgatitja e ushqimeve tradicionale, **aplikimi deri më 09.08.2019;**
- Përpunimi i pemëve dhe perimeve , **aplikimit deri më 16.08.2019;** dhe
- Përpunimi i qumështit, **aplikimi deri më 23.08.2019.**

Andaj, **ftohen** gratë e interesuara që të aplikojnë për vijimin e trajnimve në njërin nga modulet e përfshira në projekt **duke filluar nga data 18.07.2019.**

Aplikimi duhet bërë në Zyrën e Grupit Lokal i Veprimit GLV dhe në Departamentin për Bujqësi në Komunën e Vitisë, ku mund të merren aplikacionet dhe pas plotësimit, duhet bashkangjitur edhe kopja e leternjoftimit.

KRITERET QË DUHET PLOTËSUAR GRAT PËR TRAJNIME JANË:

- ✓ Të jenë me moshë 18-55 vjeç dhe të jenë nga Komuna e Vitisë;
- ✓ Gatishmëria për të qenë pjesë e trajnimeve;
- ✓ Të papuna dhe në situatë të rëndë ekonomike;
- ✓ Të kenë lëndë të para;
- ✓ Të jenë të interesuara për të filluar një biznes apo për t'u vetëpunësuar.

Sinqerisht,
Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv i IADK-së



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA